



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 2024/ Prot
14

Tiranë, më 16.02 2024

V E N D I M

Nr. 6, datë 16.02 2024

Për

“Përcaktimin e sipërmarrësit One Albania Sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm One Albania dhe vendosjen e masave rregulluese për FNT”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

1. Z. Tomi	Frashëri	Kryetar
2. Znj. Edlira	Dvorani	Anëtare
3. Z. Lorenc	Bako	Anëtar
4. Z. Bleron	Dokle	Anëtar
5. Z. Armer	Juka	Anëtar

dhe sekretare Znj. Evblina Taci, në mbledhjen e datës 16.02.2024, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, si dhe Ligjit nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, me propozim të Drejtorisë së Tregjeve dhe Masave Rregullatore, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Përcaktimin e sipërmarrësit One Albania Sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm One Albania dhe vendosjen e masave rregulluese”.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 31 e në vijim i Kreut VI (Rregullimi i Konkurrencës) të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (Ligji nr. 9918/2008);

2. Ligji nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” (Ligji nr. 44/2015);
3. Rregullore Nr.9 “Për Analizën e Tregut”, miratuar me VKD nr.747, date 17.07.2009, e ndryshuar;
4. Rregullore për Procedurat e Këshillimit Publik, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr.21, datë 7.12.2021.
5. Vendim Nr.____, datë _____.2024, i Këshillit Drejtues të AKEP për “Miratimin e Dokumentit “Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare - Dokumenti Përfundimtar””.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Projekt-vendimi për “Përcaktimin e sipërmarrësit One Albania Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm One Albania dhe vendosjen e masave rregulluese”;
 2. Dokumenti: *Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare - Dokumenti Përfundimtar*;
 3. Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit;
- si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V E R E N:

1. Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin Nr.16 datë 16.11.2023, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “Analizë e tregut të shërbimeve celulare: Tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare – Këshillim Publik”.
2. Procedura e Këshillimit Publik u zhvillua për një periudhë 60 ditore nga data e publikimit të dokumentit në faqen e internetit të AKEP. Dokumenti u publikua në faqen e Internetit të AKEP¹ dhe këshillimi publik u krye për një periudhë 60 ditore më 16.11.2023 – 16.01.2024.
3. Për dokumentin “Analizë e tregut të shërbimeve celulare: Tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare – Këshillim Publik” në AKEP depozituan komente palët e mëposhtme të interesuara si vijon:
 - Vodafone Albania sh.a me shkresën LEA/001/LR, JL, datë 08.01.2024 (referenca e AKEP Nr.2024/7 prot., datë 12.01.2024);
 - One Albania sh.a me shkresën Nr.108 Prot., datë 15.01.2024 (referenca e AKEP Nr.2024/8 prot., datë 15.01.2024);
 - Neofone shpk me shkresën Nr.380 Prot., datë 12.01.2024 (referenca e AKEP Nr.2024/9 prot., datë 16.01.2024);

¹ <https://akep.al/wp-content/uploads/2023/11/Keshillim-publik-Dokumenti-Analiza-e-tregut-te-terminimit-te-thirrjeve.pdf>

- Autoriteti i Konkurrencës me shkresën Nr.41/2 Prot., datë 16.01.2024(referenca e AKEP nr.2024/10 Prot., datë 22.01.2024).
4. Tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme, janë pjesë e listës së tregjeve të miratuara në rregulloren e AKEP me Nr. 9, datë 17.07.2009 “Për Analizën e tregut”, e ndryshuar gjithashtu edhe pjesë e tregjeve për rregullim sipas rekomandimeve të Komisionit Evropian të vitit 2007 dhe vitit 2014, dhe për këtë arsye AKEP nuk e konsideron të nevojshme të bëjë një analizë të tre kritereve nëse këto tregje janë tregje përkatës të justifikueshëm për ndërhyrje *ex-ante*.
5. Bazuar në rregulloren Nr. 9, datë 17.07.2009 “Për Analizën e tregut”, AKEP analizon për FNT tregjet përkatëse të mëposhtme si tregje të mundshme për ndërhyrje *ex-ante* në territorin e Republikës së Shqipërisë në fushën e komunikimeve elektronike, *inter alias*:
- a. Tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet publike të telefonisë së lëvizshme.
6. Dokumenti përfundimtar “Analizë e tregut të shërbimeve celulare: Tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celular”, dokument i cili:
- a. është përgatitur pas kryerjes së këshillimit publik të zhvilluar në përputhje me nenin 35 të Ligjit nr. 9918/2008, si dhe përmban komentet e të gjitha palëve të interesuara, dhe qëndrimin e AKEP për komentet (Aneks 1 i dokumentit);
- b. përbën një dokument të rëndësishëm rregullator në bazë së të cilit merren vendimet për FNT në tregjet e analizuar dhe masat rregulluese respektive, të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimet rregullatore dhe tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri;
- c. nga pikëpamja e rregullsisë, është në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligjin nr. 9918/2008 dhe Rregulloren për Analizën e tregut;
- d. nga pikëpamja e ligjshmërisë është në konformitet me përcaktimet ligjore të parashikuara për analizën e tregut në nenin 31 e ne vijim të Kreut VI të Ligjit nr. 9918/2008, dhe Rregullores nr. 9, përfshirë përkufizimin e detajuar të tregjeve përkatës, kriteret e përcaktimit FNT, dhe detyrimet e parashikuara për FNT;
- e. ka marrë në konsideratë rekomandimet dhe direktivat e Komisionit Evropian dhe praktikat më të mira rregullatore në vendet e Bashkimit Evropian, parimet e ligjit të konkurrencës dhe kushtet aktuale të tregut Shqiptar celular;
- f. vendosja, ndryshimi, mbajtja dhe heqja e detyrimeve për FNT është në përputhje, me përcaktimet e nenit 36 e në vijim të Kreut VI të Ligjit nr. 9918/2008, me pikën 5 të nenit 3 të Rregullores dhe me objektivat rregullatore të AKEP, të përcaktuara në nenin 7 të ligjit nr. 9918/2008;
- g. përmban arsyetimin dhe përfundimin se dy operatorët celularë përmbushin kriteret për FNT në tregun kombëtar të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare, si dhe përmban arsyetimin për masat rregulluese për FNT për terminimin e thirrjeve në rrjetet celulare;
- h. përmban detyrimet e vendosura për FNT, të cilat janë në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9918/2008 dhe bazohen në natyrën e problemit të identifikuar dhe janë

proporcionale e të justifikuara nga pikëpamja e objektivave rregullatore të vendosura në nenin 7 të ligjit nr. 9918/2008.

7. Dokumenti “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare - Dokumenti Përfundimtar*” shërben si bazë për marrjen e vendimeve për statusin me FNT në tregjet e analizuara për terminimin e thirrjeve, dhe masat rregulluese për sipërmarrësit e përcaktuar me status me FNT.

A T E H E R E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të këtij vendimi për konkurrencën në treg, sipërmarrësin dhe realizimin e objektivave rregullatore, në mbështetje të pikës 1 të nenit 114, pikës 1 të nenit 115 të ligjit nr. nr. 9918/2008, si dhe në zbatim të kompetencës ligjore të përcaktuar në shkronjën ç) të nenit 8 të ligjit nr. nr. 9918/2008, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Bazuar në dokumentin “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare - Dokumenti Përfundimtar*”, miratuar me VKD Nr. __, datë __. __.2024, të përcaktojë sipërmarrësin One Albania Sh.a. sipërmarrës me FNT në tregun përkatës:
 - tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetin telefonik publik të lëvizshëm të One Albania².
2. Sipërmarrësi One Albania sh.a. i përcaktuar sipërmarrës me FNT, për shërbimin e terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetin telefonik publik të lëvizshëm, është i detyruar të zbatojë të gjitha detyrimet përkatëse si më poshtë, por pa u kufizuar:
 - 2.1 Detyrimin e mosdiskriminimit, sipas nenit 39 të ligjit nr. nr. 9918/2008.
 - 2.2 Detyrimin e transparencës, sipas nenit 40 të ligjit nr. nr. 9918/2008.
 - 2.3 Detyrimin për akses dhe interkoneksion dhe përdorimin e përbashkët të faciliteteve të rrjetit, sipas nenit 42 të ligjit nr. nr. 9918/2008.
 - 2.4 Detyrimin për kontroll të tarifave, sipas nenit 45 të ligjit nr. nr. 9918/2008.
3. Detyrimet e mësipërme në pikën 2, përfshijnë midis të tjerave:
 - 3.1 **Detyrimi i Mosdiskriminimit**
 - a. Sipërmarrësi One Albania Sh.a., të zbatojë kushte të njëjta, në rrethana të njëjta ndaj sipërmarrësve të tjerë, që ofrojnë shërbime ekuivalente, si dhe t’u ofrojë sipërmarrësve të tjerë shërbime dhe informacion në kushte të njëjta dhe me cilësi të njëjtë, sikundër ai i ofron për shërbimet e veta, për filialet ose partnerët e tij

² Përkufizimi i tregut përkatës është dhënë në dokumentin përfundimtar të analizës së tregut miratuar me VKD nr. __, datë __. __.2024 dhe statusi me FNT është vetëm për terminimin e thirrjeve të origjinuara nga pajtimtarët e rrjeteve celulare dhe fikse kombëtare.

- b. Sipërmarrësi One Albania Sh.a., të përditësoje Ofertën Referencë të Interkoneksionit, për ta përshtatur me ndryshimet dhe nevojat e tregut, brenda 45 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi;
- c. Sipërmarrësi One Albania Sh.a., të publikojë marrëveshje të Nivelit të Shërbimit (*Service Level Agreement-SLA*), si dhe Tregues Kryesore të Performancës (*Key Performance Indicators -KPI*) për interkoneksionin sipas përcaktimeve të Rregullores së Akses dhe Interkoneksionit.

3.2 *Detyrimi i transparencës:*

Oferta Referencë e Interkoneksionit e përditësuar nga One Albania sh.a duhet të përshijë informacionin e mëposhtëm të nevojshme për interkoneksion me One Albania sh.a:

- a. Specifikimet teknike;
- b. Karakteristikat e rrjetit;
- c. Termat dhe kushtet për ofrimin dhe përdorimin;
- d. Tarifat, përfshirë zbritjet e mundshme.

3.3 *Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit*

Sipërmarrësi One Albania Sh.a., për terminimin e thirrjeve në rrjetin celular, duhet:

- a. të interkonektojë rrjetet ose facilitetet e rrjetit dhe të ofrojë akses në shërbimet shoqëruese;
- b. të ofrojë shërbime të veçanta në nivel shumice, për t'u rishitur nga palët e treta;
- c. të mos anulohet aksesin në facilitetet, kur e ka dhe në atë;
- d. të negociojë me dëshirën e mirë dhe me mirëbesim me subjektet, që kërkojnë akses;
- e. të ofrojë akses të hapur në ndërfaqet teknike, protokollet ose teknologjitë e tjera të rëndësishme, të domosdoshme për ndërveprimin e shërbimeve ose për shërbimet e rrjetit virtual;
- f. të ofrojë bashkëvendosje ose forma të tjera të përdorimit të përbashkët, përfshirë ndërtesat, tubacionet kabllorë ose shtyllat, kullat;
- g. të krijojë kushtet e nevojshme për të siguruar ndërveprimin e shërbimeve pike fundore – pike fundore, duke përfshirë facilitetet për shërbimet e rrjetit inteligjent dhe/ose roaming-ut në rrjetet mobile;
- h. të ofrojë akses në sistemet mbështetëse funksionale ose sistemet e ngjashme informatike (software), të nevojshme, për të siguruar konkurrencë të ndershme në ofrimin e shërbimeve.

Për geramat e., f., g., h., të mësipërme, detyrimi për akses i referohet vetëm për mundësimin e terminimit të thirrjeve në rrjetin celular One Albania, dhe janë të zbatueshme sipas mundësive/aftësive teknike dhe ekonomike të sipërmarrësit One Albania Sh.a, si edhe me tarifa të cilat mbajnë parasysh investimet e kryera dhe një normë të arsyeshme fitimi.

3.4 *Detyrimi për kontroll të tarifave*

- a. Tarifa e terminimit të thirrjeve dhe shërbimeve të interkoneksionit të lidhura me terminimin e thirrjeve në rrjetin One Albania sh.a. janë objekt kontrolli dhe rregullimi nga AKEP, sipas metodës së përcaktimit të nivelit maksimal të tyre (neni 57, pika 1 gërma 'a', të ligjit nr. 9918/2008);

- b. Në përputhje me Nenin 57, pika 1/a e Ligjit 9918, metoda e rregullimit të tarifave të One Albania sh.a i përcaktuar me FNT në tregun përkatës me shumicë të terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetin telefonik publik të lëvizshëm të One Albania , është përcaktimi i nivelit maksimal sipas vlerave dhe afateve të mëposhtëm:

	1.12.2019	01.10.2024	01.04.2025	01.10.2025 deri në një vendim tjetër të AKEP
Tarifa maksimale e Terminimit të thirrjeve (lek/min pa TVSH)	1. 11	1.02	0.89	0.75

- Sipërmarrësit One Albania Sh.a i përcaktuar me statusin me FNT për terminimin e thirrjeve kombëtare, bazuar në detyrimin e mosdiskriminimit (neni 39 i ligjit nr. 9918/2008 dhe pika 3.1 më sipër), si dhe në bazë të nenit 51 të ligjit nr. 9918/2008, i hiqet masa rregullatore për mosdiskriminim e thirrjeve mobile *on-net/off-net* (mase rregullatore e vendosur ne vitin 2014), në referencë me parashikimet e nenit 36 të ligjit 9918/2008, me zbatim të menjëhershëm.
- Sipërmarrësi One Albania Sh.a. ka detyrimin që të zbatojë detyrime dhe specifikime të tjera të përcaktuara nga AKEP, sipas nevojave të tregut, për statusin e FNT në tregun përkatës të terminimit të thirrjeve.
- Afati i vlefshmërisë së statusit me FNT për sipërmarrësin One Albania Sh.a. në tregun përkatës referuar në pikën 1 të këtij vendimi, është deri në nxjerrjen e një vendimi tjetër nga AKEP mbi bazën e analizës së tregut në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Ky Vendim dhe Dokumenti “*Analizë e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme (celulare) – Dokument Përfundimtar*”, të publikohen në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.
- Vendimet Nr. 13, datë 22.02.2018 dhe Nr.71, datë 01.10.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP shfuqizohen.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankim gjyqësor në Gjykatën Administrative të shkallës së parë Tiranë brenda afatit 45 (dyzet e pesë) ditor të përcaktuar në Ligjin 49/2012.
- Ngarkohet Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Tomi Frashëri	Edlira Dvorani	Bleron Dokle	Armer Juka	Lorenc Bako
				